

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **KEK-26-5463-5-2-1**

Sa i përket tenderit për: **Rregullimi i rregullatorit të tensionit të Transformatorit OBT-TC B**

A N K E S Ë

1. Identifikimi i ankuesit*

_____ **Grupi i OE “Valdet Tatari B.I. & M-T servis”** _____

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

_____ **QYSHK NR.42** _____

(Adresa)

_____ **PEJË** _____

(Vendi)

_____ **30000** _____

(Kodi postar)

_____ **+383 44509989** _____

(Numri Telefonit)

_____ (Numri i Faks-it) _____

_____ **Valdrin Tatari** _____

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

_____ **info@valfrigo.com** _____

(Adresa elektronike)



_____ **14.09.2026** _____

(Data e parashtrimit të ankesës)

_____ (Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka të bëjë me tenderin: **Rregullimi i rregullatorit të tensionit të Transformatorit OBT-TC B.**

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 13.07.2026 ndërsa hapja publike është bërë në datën 10.08.2026.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së përmes formularit B58 është bërë në datën 25.08.2026.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 31.08.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 03.09.2026 e refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim të dorëzuar nga ne, andaj të pakënaqur me vendimin e tillë po i drejtohem OSHP-së me ankesë.

Kriteri i dhënies ka qenë: **Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.**

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

Hapja e tenderëve është bërë në datën 10.08.2026. Në procesverbalin e hapjes së tenderëve nuk ishte evidentuar ndonjë vërejtje apo shkelje ligjore.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Njoftimi për kontratë është bërë në datën 13.07.2026 ndërsa hapja publike është bërë në datën 10.08.2026.

Njoftimi mbi Vendimin e AK-së përmes formularit B58 është bërë në datën 25.08.2026.

Të pakënaqur me Njoftimin mbi Vendimin e AK-së dhe brenda afatit të rregullt kohorë me datë 31.08.2026 iu kemi drejtuar AK-së me Kërkesë për Rishqyrtim.

AK me datë 03.09.2026 e refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim të dorëzuar nga ne, andaj të pakënaqur me vendimin e tillë po i drejtohem OSHP-së me ankesë.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 10 dhe 11 të LPP-së

AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 70 të LPP-së,

AK ka shkelur nenin 7 të RRPP-001/2022,

AK ka shkelur nenin 38 të RRPP-001/2022,

AK ka shkelur nenin 40 të RRPP-001/2022,

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së pasi që gjatë ri vlerësimit të tenderit tonë nuk e ka trajtuar atë në përputhje me kërkesat e dosjes së tenderit. Kjo ka ardhur si pasojë e asaj kur AK na ka konsideruar si të pa përgjegjshëm për kinse mos plotësim të një kërkesë që ata e kanë vendosur tek Aneksi 1 i dosjes së tenderit. Nga arsyetimi për eliminim që na ka dërguar AK dhe pas krahasimit të tij kërkesat e dosjes së tenderit, shihet se kërkesa e tillë nuk ishte e vendosur fare tek Fleta e të Dhënave të Tenderit dhe nuk figuronte fare askund që si dëshmi dokumentare duhet të dorëzohet së bashku me ofertën. Me që ne kur kemi aplikuar në tender, tek formulari i tenderit jemi pajtuar se pajtohemi me të gjitha kërkesat dhe kriteret e dosjes së tenderit, tregon se jemi pajtuar edhe me aneksin 1 të specifikimeve teknike andaj aplikimi i një kërkesë që ishte në aneksin 1 gjatë kohës së vlerësimit konsiderohet shkelje e plotë e ligjit dhe njëkohësisht diskriminim i pastër i tenderit tonë. Vlen të thuhet edhe kjo se AK nuk e ka trajtuar si duhet as ofertën e GOE që e ka shpallur fitues pasi që i njëjti nuk e posedon Autorizim nga Prodhuesi për kryerjen e servisimit të OLTC-ve të tipit përkatës. Edhe pse të nuk e kemi parë me që AK nuk na ka dhënë qasje në dokumente të tilla, nga tenderët tjerë e dimë se ky tenderues nuk e ka autorizimin ashtu siç ishte kërkuar andaj me të drejtë konsiderojmë se AK ka shkelur plotësisht nenin 7 të LPP-së duke e favorizuar GOE që e ka shpallur fitues dhe duke na diskriminuar neve si tenderues i përgjegjshëm me çmimin më të ulët në krahasim me tenderët e përgjegjshëm konkurrent. Nga krejt kjo po shihet se AK ka aplikuar gabimisht kërkesën për garancionin e cila nuk ishte e vendosur tek FDT por ishte tek Aneksi 1 dhe si rrjedhojë ka ardhur edhe deri tek zbatimi i gabuar i nenit 59 të LPP-

së. Sipas asaj që e thotë neni 7 i LPP-së, kjo konsiderohet trajtim jo i drejtë i tenderit tonë përkatësisht diskriminim i plotë i tenderit tonë e që njëherit konsiderohet edhe shkelje e rëndë e kësaj dispozite ligjore. Më detalisht për secilin gabim të AK-së që ka bërë gjatë këtij procesi të ri vlerësimit të tenderit tonë, do ju njohim në pretendimet në vazhdim.

2. AK ka shkelur nenin 10 dhe 11 të LPP-së pasi që edhe përkundër kërkesës tonë dhe lejimit nga LPP që të kemi qasje në tenderët e OE tjerë, AK nuk na ka lejuar qasje të plotë tek tenderi i OE të shpallur fitues. Ja si duket kërkesa jonë dhe ja si duket përgjigja nga AK:



valfrigo
GREEN ENERGY

Për: **KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES sh.a.**

Zyra e Prokurimit

DATA : 26.08.2026

LËNDA: Kërkesë për qasje në Raportin e Vlerësimit dhe Ofertën e OE të rekomanduar për kontratë :

NR E PROKURIMIT: KEK-26-5463-5-2-1

TITULLI I KONTRATËS: "Rregullimi i rregullatorit të tensionit të Transformatorit OBT-TC B"

I nderuar Autoritet Kontraktues,

Në mbështetje të Nenit 105 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, I ndryshuar dhe plotësuar me ligjet pasuese, ne si palë e interesuar dhe pjesëmarrëse në këtë aktivitet prokurimi, kërkojmë zyrtarisht qasje dhe kopje të dokumenteve të mëposhtme:

Raportin e plotë të Vlerësimit të Tenderëve të hartuar nga Komisioni i Vlerësimit për këtë aktivitet të prokurimit.

Kopjen e plotë të Ofertës (pjesës teknike dhe profesionale) të Operatorit Ekonomik të rekomanduar për shpërbllim me kontratë: "Grupin e Operatoreve Ekonomik Ballkan Petrol SH.P.K. & ELPROM HEAVY INDUSTRIES JSC, Zona Industriale Gërlice, 70000, Ferizaj"

Kjo kërkesë bëhet me qëllim të analizimit të rrjedhës së vlerësimit dhe përgatitjes së hapave të mëtejshëm ligjorë sipas Nenit 108/A të LPP-së. Ju lutemi që dokumentet të na vihen në dispozicion në formë elektronike brenda afatit ligjor.

Me Respekt,

NPT VALFRIGO





KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES S.A.
KOSOVO ENERGY CORPORATION J.S.C.
ENERGETISKA KOPRORACIJA KOSOVO D.D.

Njoftim

KORPORATA ENERGETIKE E KOSOVES

Rr. Nëna Terezë nr. 36, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

Nr. i prokurimit:	KEK-26-5463-5-2-1
Nr i brendshëm	KEKC 26 302 521

Titulli: “Rregullimi i rregullatorit të tensionit të Transformatorit OBT-TC B”

I/e ndëruar

Ju njoftojmë se qasje ne dokumentacion mund te keni neser me datë 27.08.2026 në ora 09:30.

Personi që do të ketë qasje duhet të prezantoj autorizimin e kompanisë së juaj. Ju lutemi të sjellni me vete një USB të formatizuar (USB me shënime nuk pranohet).

--	--

Me respekt:

ZEP KEK-sh.a

Prishtinë

26.08.2026

Pavarësisht kësaj, AK nuk na ka dhënë qasje në disa nga dokumentet duke u thirrur në një kërkesë për sekret afarist të GOE të shpallur fitues edhe pse ajo kërkesë nuk e plotëson kushtin e kërkuar nga nenin 11 i LPP-së për tu pranuar si komplet e rregullt. Kërkesa e tillë madje nuk e ka plotësuar as kushtin për të qenë e vlefshme pasi që nuk e plotëson paragrafin 3 të nenit 11.3 të LPP-së. Kjo kërkesë nuk e ka të plotësuar deklaratë me shkrim: **(i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstrojnë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.**

Mos plotësimi si duhet i tabelës së dytë të kërkesës sipas nenit 11.3.3 të LPP-së e bënë kërkesën e pa rregullt dhe të pa pranueshme e që tregon hapur se AK nuk është dashur ta respektoj, dhe se është dashur të na lejoj qasje në tërë dokumentacionin e tenderit. Me që kërkesës së tillë i mungon deklarata mbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyet pse do duhet të shfaqej që është kusht i nenit 11.3.3 të LPP-së atëherë ne është dashur të na jepet qasje dhe dëshmitë e nevojshme sipas asaj që e ka parapa ligji dhe interpretimi i KRPP-së.

Ja si e kërkon nenin 11 i LPP që kjo deklaratë të jetë e plotësuar:

Neni 11
Informatat Sekrete Afariste

3. Autoriteti kontraktues mund t'i klasifikojë informatat e tjera si informatë sekrete afariste vetëm nëse informata përkatëse i përmbushë këto tri kritere:

3.1 që atë ta ketë dërguar një operator ekonomik në përputhje me kërkesën e përcaktuar nga autoriteti i tillë kontraktues sipas nenit 68 ose 69 të këtij ligji;

3.2 që operatori përkatës ekonomik t'i ketë dërguar autoritetit kontraktues kërkesën me shkrim duke shprehur dëshirën e tij që autoriteti kontraktues t'i mbajë artikujt e tillë si sekret; dhe

3.3 kërkesa e tillë me shkrim të përmbajë një deklaratë me shkrim (i) në të cilën vërtetohet se një element i tillë nuk është pronë publike, dhe se të dhënat mbrohen nga operatori ekonomik nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia, dhe (ii) me të cilin parashtrohen arsyet, që bindshëm demonstronjë, sipas gjykimit të arsyeshëm të autoritetit kontraktues, se qasja publike në elementin e tillë do të rezultonte në dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit të tillë ekonomik.

Krahasuar me këtë, kërkesa për konfidencialitet nuk e plotëson kushtin për tu respektuar dhe se AK është dashur të na lejoj qasje të plotë në dokumentacionin e tenderit të këtij tenderuesi. Si rezultat i kësaj ne nuk kemi njohuri të sakta se çka ka plotësuar e çka jo nga kërkesat e dosjes së tenderit për Autorizimin e prodhuesit dhe për ISO certifikatat të cilat AK nuk na i ka prezantuar madje as në formatin e pastruar. Nisur nga kjo lirisht mund të themi se AK ka shkelur nenin 10 dhe nenin 11 të LPP-së edhe me rastin e mos përgatitjes së versionit të pastruar të dokumenteve sipas kërkesë së paragrafit 4 dhe 5 të nenit 11 të LPP-së dhe sipas interpretimit të KRPP-së sepse nuk i ka përgatitur dokumentet sipas kërkesave të këtyre paragrafëve dhe interpretimeve edhe përkundër kërkesës së vazhdueshme nga ne. Ja si e thotë këtë neni në fjalë:

Neni 11
Informatat Sekrete Afariste

4. Autoriteti kontraktues që e ka klasifikuar një element të informatës si informatë sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, do të përgatit versionin e "pastruar" të çdo dokumenti, nëse elementi i tillë gjendet në dokumentin në të cilin po ashtu gjendet informacioni që nuk konsiderohet të jetë sekret. Versioni i tillë i pastruar duhet të përfshihet në materialin në të cilin ka qasje publiku dhe palët e interesuara sipas nenit paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të versionit të tillë të pastruar një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar disa elemente të caktuara të informatës në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesën e operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) versioni i pastruar i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe është një kopje e saktë e origjinalit pas heqjes ose fshirjes së informatave të tilla sekrete afariste.

5. Nëse dokumenti përmban vetëm informacione që autoriteti kontraktues i ka klasifikuar si informacione sekrete afariste sipas paragrafit 3. të këtij neni, dhe prandaj ky autoritet kontraktues vendos që këtë dokument ta largoj nga materiali në të cilin palët e interesuara dhe anëtarët e publikut kanë të drejtë qasjeje sipas paragrafit 3. të nenit 10 të këtij ligji, autoriteti kontraktues duhet të përgatis dhe përfshijë në dokumentacionin në të cilin publiku ka qasje, një përmbledhje të përmbajtjes së përgjithshme të dokumentit sekret. Autoriteti kontraktues do të bashkëngjisë në ballinë të përmbledhjes së tillë një njoftim që thotë se (i) autoriteti kontraktues i ka klasifikuar të gjitha informacionet që gjendeshin në dokumentin origjinal si informata sekrete afariste, me kërkesë të operatorit përkatës ekonomik, dhe (ii) se dokumenti i bashkangjitur është përgatitur nga autoriteti kontraktues dhe se është një përmbledhje e përgjithshme jo-sekrete e origjinalit.

Pra fshehja e këtyre dëshmitë nga oferta e këtij GOE, e favorizon hapur tenderuesin në fjalë ndërsa mos përgatitja e versionit të pastruar të dokumenteve konsiderohet shkelje flagrante e transparencës në procedurën e prokurimit publik. Dokumentet që ky AK na i ka fshehur

nuk janë madje as dokumente private e personale të OE dhe këtu shihet hapur që AK po e përkrah, favorizon dhe po ja fshehe ndonjë mangësi që të mos ja shohim ne. Përpos kësaj kjo fshehje e dëshmive të tilla bie ndesh edhe me nenin 7 të RRPP-001/2022 pasi që ky nen e lejon klasifikim vetëm për informacionet që lidhen me gjendjen ekonomike/financiare ose aftësitë teknike/profesionale, në kushtet e nenit 11 të LPP-së. Sipas nenit 7.6.1, AK nuk duhet ta pranojë klasifikimin kur Aneksi 3 nuk përmban të gjitha informacionet e kërkuara, veçanërisht faktet dhe argumentet që dëshmojnë dëm material nga zbulimi. Arsyetimi i paraqitur për “keqpërdorime eventuale” duhet të vlerësohet me kujdesë dokument për dokument dhe informacion më informacion, jo si arsyetim automatik për fshehjen e plotë të çdo dokumenti. Nisur nga këto dhe mbështetur çdo herë në këto dispozita ligjore që flasin për transparencën në aktivitetet e prokurimit, e sidomos në pikën 3 të nenit 10 të LPP-së dhe në pikën 3, 4 dhe 5 të nenit 11 të LPP-së shihet hapur se AK ka shkelur plotësisht nenin 10 dhe 11 të LPP-së si dhe nenin 7 të RRPP-001/2022.

3. AK ka shkelur nenin 59 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk i ka respektuar kërkesat e veta nga dosja e tenderit. Neni 59.4 i LPP-së shumë qartë e përcakton se: **Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit (përkatësisht ë fletën e të dhënave të tenderit).**

E themi këtë sepse ashtu siç e sqaruam edhe tek pretendimi i kaluar shihet se AK ka bërë gabim gjatë vlerësimit dhe për pasojë ka ardhur deri te vendimi i gabuar për eliminim tonë.

Arsyeja e eliminimit të tenderit tonë tani duket kështu:

Tenderi i juaj është i papërgjegjshme:

☒ Dëshmi të mjaftueshme, siç është përshkruar në nenet 59 të LPP, që tregojnë arsyeshëm se i përmbush kërkesat minimale të kapacitetit profesional, financiar dhe teknik të saktësuara në dosjen e tenderit apo në njoftimin e kontratës.

ARSYETIM

Ju jeni diskualifikuar për këto arsye :

1. Nuk e plotësoni kriterin e kërkuar të ANEKS 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME të Dosjes së tenderit ku kërkohet “- O.E. ne ofertë me një deklaratë të veçantë duhet të deklarojnë për garancion min. 12 muaj për pjesët e zëvendësuara dhe punët e kryera nga data e lëshimit në punë të pajisjes”, **në ofertë nuk keni dorëzuar deklaratën për garancion.**

Arsyetimi i tillë është i pabazuar dhe më shumë mendojmë se do duhej të ishte një gabim teknik i qëllimshëm i AK-së pasi që shihet qartë se në fletën e të dhënave të tenderit nuk ishte kërkuar dëshmia e tillë dokumentare që të dorëzohet me rastin e tenderimit. Me vet faktin që kjo kërkesë ka qenë e përcaktuar tek Aneksi 1, mjafton që ne kemi dorëzuar ofertë dhe specifikime teknike që të konsiderohet e plotësuar. Para se të ju dëshmojmë se je jemi plotësuar me të gjitha kushtet dhe kërkesat e dosjes së tenderit, po ju pasqyrojmë që kjo kërkesë nuk ishte kërkuar askund tek FDT e dosjes së tenderit ku duhet të vendosen dokumentet mandaare që dorëzohen me ofertë.

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>
		1. Autenticitetit i produkteve dhe cilësisë reprezentues. 2. Projekte të ngjashëm të operatorit ekonomik të realizuar në tre vitet e fundit. 3. Kualifikimet arsimore dhe profesionale të personelit të operatorit ekonomik dhe, në veçanti ato të personit apo personave që janë drejtpërdrejtë përgjegjës për sigurimin e punëve. 4. Certifikatë për punë në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet.	1. Autorizim nga prodhuesi për kryerjen e servisimit të OLTC-ve të tipit përkatës. 2. Listën me të cilën saktësohen të gjitha kontratat kryesore të rëndësishme të punëve të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, duke saktësuar llojin e punëve të përfshira, shumën e kontratës, datën dhe pranuesin. Te dëshmohet përmes referencës ose certifikatës të pranimit të punëve të lëshuara nga punëdhënësi se tenderuesi ka kryer punë të ngjashme (në OLTC të transformatorëve energjetikë) gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së këtij tenderi. 3. Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi përmes CV-se dhe kopjes së diplomës ose certificates dhe kontratës apo marrveshjes së bashkëpunimit se posedon personelin me përvojë të profileve si vijon, së paku; - 1 (një) Inxhinier të elektroteknikës. 4. Kopjet e Certifikatave të prodhuesit ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018.

Bazuar në këtë që u pasqyruar më sipër shihet se kërkesa për deklaratë lidhur me garancionin nuk ishte pjesë e FDT-së dhe me që ajo ishte diku tek Aneksi 1, mjafton që ne të deklarohejmë se pajtohemi me kushtet e tenderit dhe kërkesa e tillë konsiderohet e pranuar. Ne jemi dakorduar me të gjitha kriteret dhe kërkesat e dosjes së tenderit po ju pasqyrojmë atë që kemi deklaruar tek formulari i tenderit me rastin e ofertimit.

FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: **KEK-26-5463-5-2-1**

Titulli i kontratës: **Rregullimi i rregullatorit të tensionit të Transformatorit OBT-TC B**

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përmbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërësi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 Rregullimi i rregullatorit të tensionit të Transformatorit OBT-TC B

3. Çmimi total i tenderit është:

23,585.84 EUR

Dhe në fjalë *[shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]*

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: **90** nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

Pra nga deklarimi që kemi ofruar tek formulari i tenderit dhe nga ajo që shihet se tek pika 9.1 & 9.2 e FDT nuk ishte kërkuar deklarata e tillë, tregon se ne e kemi plotësuar kushtin e kërkuar dhe se produktet tona kanë garancion 12 muaj ashtu siç edhe ishte kërkuar tek aneksi 1.

Kërkesat të cilat duhet të dëshmohen në formë dokumentare duhet të vendosen tek FDT andaj aplikimi i kriterit të tillë për eliminimin tonë është i padrejtë dhe i pabazuar.

AK përpos kësaj besojmë se ka bërë edhe shkelje tjera gatë vlerësimit të tenderit fitues sepse i njëjti nuk e posedon autorizimin si duhet e as ISO certifikatat që ishin kërkesa mandatore të FDT-së nga dosja e tenderit. Këto dëshmi nuk i kemi parë por bazuar në projekte tjera dhe duke u bazuar edhe në atë që autorizimi i lëshuar nuk është nga **prodhuesi për kryerjen e servisimit të OLTC-ve të tipit përkatës**, tregon se kriteri i vendosur në dosje të tenderit nuk ishte plotësuar dhe se autorizimi i tillë është i pavlefshëm.

Nisur nga krejt kjo ne kontestojmë përmbushjen materiale nga grupi i rekomanduar të kriterit të FDT-së, nenet 9.1–9.2, dëshmia nr. 1, f. 15: Autorizim nga prodhuesi për kryerjen e servisimit të OLTC-ve të tipit përkatës.” Aneksi 1, f. 18, identifikon pajisjen ekzistuese si OLTC të prodhuesit MR (Maschinenfabrik Reinhausen), të tipit të përcaktuar në dosjen e tenderit. Objekti I kontratës përfshin hapjen, inspektimin, servisimin, riparimin, testimin dhe rikthimin në operim të kësaj pajisjeje. Me që në listën “Përmbajtja e ofertës – 26/2026”, datë

10.08.2026, figuron skedari “1_Authorization of Manufacturer”, mos dorëzimi i këtij autorizimi nga vet prodhuesi pajisjes ekzistuese konsiderohet kusht i paplotësuar. Ne GOE Valdet Tatars B.I. (N.P.T. “Valfrigo”) / M-T servis Zagreb d.o.o., ku M-T servis Zagreb d.o.o. është anëtar i ofertuesit/grupit dhe jo palë e tretë jashtë procedurës. Dokumenti i MR-së i datës 11.02.2026, i cili ekzistonte para afatit të ofertimit, dëshmon se Maschinenfabrik Reinhausen GmbH e kishte emëruar M-T servis Zagreb d.o.o. si “service representative” për territore që përfshijnë Kosovën dhe e kishte autorizuar të përfaqësonte MR-në në negociatë me klientë lidhur me servisimin, mirëmbajtjen dhe shitjen e OLTC-ve dhe pajisjeve përkatëse. Ky dokument dëshmon ekzistencën e marrëdhënies M-T servis-MR para afatit, por nuk paraqitet si zëvendësim i kriterit të FDT-së për autorizimin konkret të kryerjes së servisimit. Ajo paraqitet vetëm si provë shtesë në procedurën e ankimimit, nga vetë anëtar i M-T servis i GOE-së, për të mbështetur kërkesën që OSHP të verifikojë dokumentin “Authorization of Manufacturer” të operatorit të rekomanduar, lëshuesin, bazën, vlefshmërinë dhe fushëveprimin e tij në afatin e ofertimit. Nisur nga kjo kërkojmë që autorizimi i prodhuesit që ka dorëzuar GEO i shpallur fitues të verifikohet sepse i njëjti nuk është ashtu siç e kishte kërkuar vet AK. Me që ne dhe bashkëpunëtorit jonë veq jemi të autorizuar për territorin e Kosovës për prodhimet e tilla, me të drejtë konsiderojmë se autorizimi i dorëzuar nga konkurrenti është i pavlefshëm dhe nuk arrina të plotëson kërkesën e AK-së duke e bërë tenderuesin në fjalë të papërgjegjshëm.

Ne dyshojmë se tenderues në fjalë nuk ik as ISO certifikatat ashtu siç ishin kërkuar. Kërkesa ka qenë që të dorëzohen edhe **Certifikatat ISO të prodhuesit dhe lidhja me mallrat/pjesët e ofruara** FDT, f. 15, dëshmia nr. 4, kërkon kopjet e certifikatave të prodhuesit ISO 9001:2015, ISO 14001:2015 dhe ISO 45001:2018.

Lista e ofertës së grupit të rekomanduar i përmend të tria certifikatat për ELPROM, prandaj nuk pretendojmë se certifikatat patjetër mungojnë por pretendojmë se nga versioni i qasshëm nuk mund të verifikohet përmbushja materiale e kriterit siç janë bartësi i secilës certifikatë, organin certifikues, autenticitetin, vlefshmërinë në afatin e ofertimit, fushëveprimin e certifikimit dhe lidhjen me prodhuesin e mallrave/pjesëve të deklaruara në ofertë. Ky kontroll duhet të lidhet me deklaratat për prodhuesin dhe vendin e origjinës andaj dyshojmë se kjo nuk ishte plotësuar. Me që këto nuk i kemi pare me të drejtë edhe mundemi me dyshua për plotësueshmërinë e tyre.

Prandaj bazuar në krejt këtë, shihet se veprimi i AK-së për eliminimin e tenderit tonë me arsyetime që nuk qëndrojnë, dhe shpallja fitues një tenderuesi të papërgjegjshëm konsiderohet shkelje e plotë e nenit 59 të LPP-së.

4. AK ka shkelur nenin 60 të LPP-së me rastin vlerësimit të tenderëve pasi që ka shpallur si fitues një tenderues të papërgjegjshëm dh eqë posedon çmimin më të lartë se tenderi jonë. Vet fakti që ne kemi pasur çmimin më të ulët dhe se arsyetimi për eliminimin tonë konsiderohet i pa drejtë dhe i paligjshëm, konsiderojmë që AK ka shkelur plotësisht nenin 60 të LPP-së.

5. AK ka shkelur nenin 69 të LPP-së me që gatë vlerësimit nuk ika trajtuar si duhet kërkesat dhe kriteret e vendosura në përputhje me nenin në fjalë. Mos trajtimi i autorizimit të prodhuesit të OE që e ka shpallur fitues ashtu siç e kishte parashtruar kërkesën dhe

aplikimi i një kërkesë që e kishte tek Aneksi 1 e jo tek FDT për të na eliminuar neve, konsiderohet shkelje e plotë e nenit 69 të LPP-së.

6. AK ka shkelur nenin 72 të LPP-së pasi që gjatë vlerësimit nuk ka kërkuar sqarime shtesë nga ne për tu siguruar se a qëndrojmë prapa deklarimit se produktet tona kanë garancionin e kërkuar prej 12 muajve. Neni 72.3 i LPP-së shumë qartë e thotë se:

Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë që të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati të caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

Bazuar në këtë shihet se AK është dashur të kërkojë sqarime nga ne dhe jo të na eliminojë nga konkurrenca edhe pse e kemi plotësuar të gjitha kushtet e kërkuara tek FDT e dosje së tenderit si dokumente mandatore të kërkuara për dorëzim së bashku me ofertën tonë.

Nisur nga gjendja faktike dhe nisur edhe nga ato që u thanë me lartë, kërkojmë nga OSHP që të marr:

V E N D I M

APROHOHET si e bazuar ankesa e Grupit të OE “Valdet Tatari B.I. & M-T servis” lidhur me tenderin “**Rregullimi i rregullatorit të tensionit të Transformatorit OBT-TC B** i iniciuar nga **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.**..

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK për anulim të tenderit i publikuar nga **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVES sh.a.** dhe lënda të kthehet në **ri-vlerësim**.

Ri-vlerësimi të bëhet plotësisht duke u bazuar në dispozitat ligjore të LPP-së, kërkesat e dosjes së tenderit e sidomos ato të specifikimit teknik, që realisht më pas do duhej që **FITUES** të shpallëj **Grupi i OE “Valdet Tatari B.I. & M-T servis”**.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për tenderim dhe kontratë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

-  302 Dosja e Tenderit (shq)
-  302 Njoftim për pezullim -01.09.2026 (shq)
-  302 NJOFTIM PER VENDIMIN E AK
-  302 Pershkrimi cmimeve furnizim
-  302-1 Përgjigje per pyetjet e parashtruara_shq
-  302-NJOFTIM-04.09.2026
-  B05 Njoftim per Kontrat (1)
-  B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve (KEKC 26 302 521)
-  B54 Formulari standard per korrigjimin e gabimeve ne njoftimet e publikuara (1)
-  RISHQYRTIMI I KERKESES KEKC 26 302 521 Valdet Tatari B.I

Dëshmitë tjera lidhur me pretendimet tona i gjeni tek oferta e tenderuesit t shpallur fitues dhe tek tenderi jonë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*